



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 40/4 Prot.

Tiranë, më 12/01 /2026

V E N D I M

Nr. 6, datë 12.01.2026

**“PËR NJË NDRYSHIM NË PIKËN 1 TË VENDIMIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT NR. 61, DATË 24.12.2025 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2025-
2026”**

Bordi i Administrimit, në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 3, pika 2, neni 59, pika 8, neni 39 dhe 40; VKM-së nr. 112, datë 23.2.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", e ndryshuar; VKM-në me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik"; Udhëzimin nr. 36, datë 23.11.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 29, datë 10.06.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar, kreu II, pika 8; Statutin e UBT-së të miratuar me Urdhrin nr. 586, datë 02.12.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nenet 14, 16, pika 5, germa "f", Rregulloren "Për procedurat e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin Bujqësor të Tiranës" Kreu V, neni 14; Vendimin e Senatit nr. 26, datë 02.07.2018 "Mbi miratimin e rregullores së ciklit të tretë të studimeve – Doktoraturë", Praktikës me nr. 3303 prot., datë 27.10.2025, Vendimin e Rektoratit të UBT-së me nr. 46 datë 13.11.2025; Vendimin e Senatit Akademik nr. 53, datë 17.12.2025; Vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 61, datë 24.12.2025, Kërkesën e Departamentit të Matematikës dhe Informatikës të përcjellë nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit me nr. 40 prot., datë 07.01.2026, Relacionin "Për shtimin e pedagogut me kohë të pjesshme në listën e miratuar për vitin akademik 2025–2026, pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit" me nr. 40/1 prot., datë 07.01.2026, Vendimin e Senatit Akademik Nr.3, datë 08.01.2026, si dhe bazuar në Relacionin e Administratorit të UBT-së me nr. 40/3 prot., datë 09.01.2026, në mbledhjen e tij të datë 12.01.2026,

VENDOSI:

1. Pika 1 e Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 61, datë 24.12.2025 bëhet:
" Të miratojë listën e personelit akademik me kohë të pjesshme për secilin Fakultet për vitin akademik 2025-2026, në total fitues 58 (pesëdhjetë e tetë;) dhe pika 1 germa a) bëhet:
a) Personeli akademik me kohë të pjesshme që do të trajtohet financiarisht pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës është 44 (dyzet e katër) kandidatë në total.

2. Të gjitha pikat e tjera të Vendimit të Bordit të Administrimit me nr. 61, datë 24.12.2025, mbeten të pandryshuara.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike dhe Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Matilda SHABANI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Edmond KADIU

Anëtar

Blerina DUKA

Anëtar

Altin PRENGA

Anëtar

Ilir KUSI

Anëtar

